



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **02.10.2023** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Arian Shatri, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 11. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 24. <u>Melis Smakic, GIBI.</u> |
| 12. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |
| 13. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, të KDI-së zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: https://www.youtube.com/watch?v=HE_vK3J-844 : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e jashtëzakonshme të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Procesverbali

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e katër (24) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Marrja e vendimit për themelimin-Ri themelimin e vend gjuetisë së përbashkët në komunën e Istogut.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- a jeni që të procedojmë me këtë pikë të rendit të ditës?

Konstatohet që në mënyrë unanime votohet që të procedojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- pa u vonuar më shumë fjalën ja kaloj nënkryetarit të komunës z. Ali Nimanaj.

Ali Nimanaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Siç ju informoj dhe kryesuesi kjo mbledhje e jashtëzakonshme është thirrur me një pikë të rendit të ditës mbi themelimin-Ri themelimin e vend gjuetisë së përbashkët në komunën e Istogut. Jemi afër fund vitit dhe në mënyrë që ti zëmë procedurat që të vazhdojmë tutje mbi bazën ligjore, duhet ta kemi parasysh që duhet të dërgohet vendimi edhe në MAPL për konfirmim të ligjshmërisë, kemi kërkuar që të thirret kjo mbledhje e jashtëzakonshme në mënyrë që të jemi në përputhje me afatet ligjore dhe ta kemi ri themelimin e vend gjuetisë brenda këtij viti. I kemi propozuar Kuvendit që të marrim vendim sot këtu dhe të vazhdojmë tutje mbi procedurat e themelimit ri themelimit të vend gjuetisë, që mos ta zgjati më shumë për detaje fjalën ja kaloj drejtorit të drejtorisë për Bujqësi si iniciues i këtij propozimi ta elaboroj para anëtarëve të Kuvendit këtë kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori z. Astrit Hajrizaj.

Astrit Hajrizaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor për prezantimin. Vetëm ta re kapitulojmë edhe njëherë, në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 1 pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 paragrafi 19.2 të Ligjit Nr. 02/L-53 Për Gjuetinë, nenit 2 dhe nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.10/2007 Për Kriteret e Caktimit të Zonave dhe Procedurat për Themelimin e Vendgjuetive, dhe pas sigurimit paraprak të pëlqimit Nr. 3762/2 të datës 26.09.2023 nga ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. D.m.th është e re kapitulluar çdo gjë me ligj me pëlqime nga ministria,

është një pikë shumë e ndjeshme ashtu siç e tha edhe drejtori por edhe nënkryetari. E hap debatin rreth kësaj pike, a dëshiron dikush fjalën? Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Kisha pyetje për drejtorin, a i kanë analizuar mangësitë që i ka pasur përpara para kësaj ri themelimi, cilat pra kanë qenë mangësitë dhe cilat janë përparësitë e kësaj pjese të përbashkët të bjeshkës "Mokna". U pa që nuk është vetëm prona komunale aty ka edhe pronë private e ka në statistika edhe sa është prona private, sigurisht që duhet të vendosen disa kufijë aty edhe duhet sigurisht të emërtohen me tabela nga guxojnë qytetarët të bëjnë gjueti. U pa që janë disa prej kafshëve që i kanë të lejuar t'i gjuajnë, mirëpo një pjesë e kafshëve ishin të palejuara, derri i egër, e të tjera. Me thënë konkretisht cilat kafshë janë në mbrojtje të gjuetisë? Me një fjalë me vendos një lloj harte nga munden të bëjnë gjueti qytetarët, se tani po e marrim parasysh se është bërë zhvendosja e vendeve të gjuetisë, na shpjegoj në pika të shkurta drejtori por desha edhe njëherë këto kërkesa që i pata. Faleminderit!

Astrit Hajrizaj- faleminderit për pyetjet profesoreshë! Paraprakisht e sqarova, d.m.th mangësitë që i kemi pasur. Sipërfaqja e cila ka qenë në pëlqimin e kaluar ka qenë komplet sipërfaqja e territorit të komunës së Istogut, nuk kanë qenë të zbritura as pjesa e parkut që është e trajtuar me ligj të veçantë ku ndalohet gjuetia, as pjesët e vendbanimeve, rrugëve, lumenjve, objekteve fetare, varrezave, kopshteve, pjesa e vendbanimeve në afërsi prej 300 m prej vendbanimeve, këto kanë qenë mangësitë edhe pse është sjellë në Kuvend dhe është miratuar dhe ka qenë në rregull. Sa i përket kafshëve të cilat janë të ndaluara për gjueti dhe të cilat janë të mbrojtura në mënyrë strikte është kaprolli, dhia e egër, ariu, ujku, macja egër, ketri, gjeragjina, bukla e vogël, korbat e zinj etj, këta janë të ndaluar d.m.th janë të mbrojtur me ligj dhe të mos zhvillohet gjueti mbi këto kafshë.

Ajshe Metaj- a e keni parë konfiguracionin e asaj pjese d.m.th me i vendos ato pika strategjike tabelat se ku mund të operojnë gjuetarët. Se është e pranishme edhe prona private e mos te ketë konflikte.

Astrit Hajrizaj- faleminderit për pyetjen se mbeta pa ta sqaruar këtë pjesë. Në momentin që themelohen vend gjueti të përbashkëta përfshinë pronat publike dhe private, d.m.th në të cilat lejohet në pjesët që thamë më herët që lejohet të zhvillohet gjueti. Hiqen pjesët në të cilat është e ndaluar, pra nuk qëndron ajo që është pronë private dhe ndalohet vend gjuetia, pra lejohet, për atë arsye po bëhet ri themelimi i vend gjuetive të përbashkëta që zhvillohet në prona publike dhe private. Sa i përket shenjave, kjo vazhdon me procedurat se kush është përfituesi e merr që ta menaxhoj vend gjuetinë. Faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit- përshëndes praninë e kryetarit të komunës z. Ilir Ferati që na është bashkëngjitur në mbledhje. Faleminderit kryetar! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj-përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë mendoj që Lëvizja Vetëvendosje mendon që mbledhja e jashtëzakonshme nuk ka qenë e nevojshme, nuk është që jemi duke i mbajtur në ushqim këto kafshë dhe sa më shpejt të intervenojmë, u përmenden disa afate kohore por si pikë së pari nuk ka qenë e nevojshme mbledhja e jashtëzakonshme. Pika e dytë, akti i themelimit, ne mendojmë që vend gjuetia normal që

duhet të themelohet, është e rëndësishme të themelohet por ky akt që na është sjellë përpara është i përpiluar në mënyrë shumë amatoreske, dhe te kjo e kisha pasur një pyetje për drejtorin ose kush do që dëshiron të përgjigjet, profesionin e anëtarëve të komisionit, pos kësaj shihet këtu te kushtet klimatike ju kanë referuar vitit 1965, e ne e dimë që kushtet klimatike duke pasur parasysh ngrohjen globale ndryshojnë. Te tabelat, janë dy tabela gati të njëjta më lartë shkruan për kafshët të cilat janë të ndaluara ndërsa në tabelë nuk figurojnë që janë të ndaluara, që dikush mundet të keqkuptojë këtë, pos asaj janë të përfshirë macja e egër, te numri katër thotë: që janë vetëm tri, ndërsa më poshtë te macja egër te numri 26 thotë që janë 100. D.m.th ky akt i themelimit është bërë në mënyrë aq amatoreske sa që ne si Lëvizje Vetëvendosje, nuk mundemi të marrim vendim sot për këtë akt themelimi, nuk mundemi të votojmë për pra dhe propozojmë që të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe të përpilohet pak më mirë, p.sh edhe tek tabela ku janë kolonat thotë gjithsejtë kolona dy plus tre, ndërsa në tabelë nuk ka kolonë dy fare. Nuk është puna që është harruar një numër por tregon seriozitetin e punës që e ka bërë ky komision. Prandaj pyetja kryesore është, kisha dashur ta di çfarë profesioni kanë anëtarët e komisionit edhe a kanë marrë mëditje për hartimin e këtij akti për themelimin e vend gjuetisë, me një fjalë Lëvizja Vetëvendosje voton sot kundër këtij akti. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Florin! Për thirrjen e mbledhjes jam i obliguar, unë e dhashë sqarimin por ndoshta jo në detaje, por ky vendim pasi të dërgohet në ministri për konfirmim të ligjshmërisë dhe pastaj e kthejnë afatin për tenderim se kjo është thirrje publike dhe duhet të ju nënshtrohet ankandit edhe në prokurim, kështu që deri me 30 tetor është afati i fundit, për mos të humbur pastaj se shkon edhe janari e shkurti deri në pranverë i hup edhe kuptimi hapjes së sezonit të gjuetisë ose dhënies të asaj që do të merret tamam rregullorja që po e përgatitim ne, pëlqimi i ministrisë së Bujqësisë, gjithashtu e dhashë edhe bazën ligjore ku mbështetet pra kjo është arsyeja. Për një ditë që nuk e ka kthyer ministria pëlqimin se kjo ka pasur të hyj si pikë e rendit ditës në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur me datë 25.09.20223 e pëlqimi ka ardhur me datë 26.09.2023, e kemi miratuar shkaku i buxhetit, e kemi mbajtur mbledhjen me datë 25.09.2023, kështu kemi qenë të penalizuar, sepse nuk kemi dashtë ta thërrasim këtë mbledhje, por obligohemi për hir të ruajtjes siç e tha edhe drejtori të faunës e pastaj e ngërthen në vete edhe ruajtjen e florës në komunën tonë. Për sugjerime tjera të vlefshme sigurisht që drejtori do t'i inkorporojë. Fjalën e ka drejtori Astriti Hajrizaj.

Astrit Hajrizaj- faleminderit profesor për pyetjet! Fillimisht kur bëhet një hulumtim i tillë marzha e gabimit ekziston dhe kjo pjesë siç e thamë ka kaluar filtër në ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Nëse eventualisht ka ndonjë gabim teknik apo lëshime, kjo rregullohet në mënyrën që përgatitet materiali për ankand dhe nuk del në mënyrë publike të ofertimit pa u shqyrtuar çdo detaj para publikimit, përderisa e kemi marrë një pëlqim nga ministria, kafshët që siç i sqarova edhe me profesoreshën Ajshe, që janë të ndaluara se janë të mbrojtura me ligj në mënyrë strikte dhe punohen në atë mënyrë që rregullohet të gjitha para se te dalin në ofertim. Faleminderit!

Florin Dreshaj- i pata edhe disa pyetje p.sh profesioni i anëtarëve të komisionit edhe kisha një pyetje për nënkryetarin, që e përmendi tenderimin, kujt keni vendosur të ja jepni këtë tender?

Kryesuesi i Kuvendit- kujt të ja jep ankandi Florin nuk ka dilema. Fjalën e ka drejtori Astrit Hajrizaj.

Astrit Hajrizaj- në përbërjen e këtij komisioni kemi inxhinier të pylltarisë, teknik të pylltarisë kemi inxhinier të gjeodezisë. Arsyeja pse janë marrë pikërisht këta persona, është sepse kanë pasur mundësi më shumë të lëvizin në terren të kenë sa më shumë informacione më të sakta përgjatë tërë territorit, kanë pasur mundësi të shohin edhe në mënyrë faktike kafshët të cilat jetojnë në territorin tonë po ashtu për shkak të koordinatave dhe kufijve nevojitet edhe në aspekt ligjor një gjeodet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka nënkryetari i komunës z. Ali Nimanaj.

Nënkryetari i komunës- përshëndet të gjithë të pranishmit! Florin besoj që unë isha i qartë në hyrje në fjalim kur e dhashë t'i shpjegova procedurat. Ndërsa kush ka me e marrë dhe kush i merr tenderat me thënë të drejtën nuk e di se kurrë në jetën time nuk jam përzier në ato punë e them me përgjegjësi të plotë morale penale dhe politike. Nëse ke ti dikujt me ja dhënë ose ke me e rekomanduar dikë zyrën e din poshtë dhe shkon e rekomandon. Është ligji që e rregullon fushën e prokurimit publik janë organet mbikëqyrëse, ti besoj i ke lexuar ato ligje i di ato kriteret ato rregullore, ku mendon që ka ndërhyrje, ju lutem ju ftoj jo vetëm ty por edhe këdo tjetër këtu që janë prezent bashkërisht të ndjekim procedurat ose t'i shkojmë deri në fund. Mos të bëjmë me gisht, të ftoj edhe njëherë publikisht të deklarosh.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit nënkryetar! Fjalën e ka Arianit Selmanaj.

Arianit Selmanaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam një pyetje për drejtorin e Bujqësisë z. Astrit Hajrizaj diçka më shumë për planin zhvillimor të vend gjuetisë edhe planin menaxhues kush menaxhon me vend gjuetinë. Faleminderit!

Astrit Hajrizaj- faleminderit Arianit për pyetjen! Sa i përket pyetjes për Plan Zhvillimor të vend gjuetisë sigurisht është e përcaktuar me ligj dhe mundesh me marrë komplet materialin në Ligjin Nr. 02/ L-053 ku janë të caktuara kriteret dhe obligimet e personit i cili është përfitues të menaxhoj me vend gjuetinë. Duhet të ceket që kjo mbikëqyret edhe nga pjesa e komunës por edhe nga pjesa e ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural d.m.th kriteret e caktuara me ligj e kanë për obligim personat që janë përfitues të menaxhojnë me vend gjueti, e kanë për obligim ta zhvillojnë ta rritin florën dhe faunën dhe jo ta dëmtojnë sepse në çdo moment është e përcaktuar pjesa ku mund të ndërpritet kontrata dhe të ju merret e drejta. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit nënkryetar! Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E dëgjova me vëmendje drejtorin, dhe nënkryetarin të cilët e elaboruan, Istogut i duhet një vend gjueti, nëse e bëj një pyetje a e meriton Istogu me e pas një vend gjueti e meriton, kështu që pe shoh që ka ardhur situata bukur e ndjeshme, e kemi një kohë shumë të shkurtër prandaj e kam vetëm një kërkesë prej kryetari, që me ekzekutivin sa më shpejt le t'i përcjellë këto afate dhe të mund të arrijmë kohën që të pajisemi me këtë vend gjueti, sepse komuna e Istogut ka shumë gjuetarë dhe me padurim e presin këtë vend gjueti. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Këtu hyn edhe peshkataria, a di mos të keqkuptohemi. Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Po konsideroj që është konsumuar

debati, drejtori e ka përgatitur mjaft mirë në kuadër të asaj që e kemi marrë edhe pëlqimin nga ministria. Kush është që kjo të miratohet?

Konstatohet që nga 24 anëtar të pranishëm me 19 vota për dhe 5 kundër miratohet pika e rendit të ditës 'Marrja e vendimit për themelimin-Ri themelimin e vend gjuetisë së përbashkët në komunën e Istogut'.

Falënderon të gjithë për kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:50.

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova